



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29, DATË
30.3.2023, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, dhe nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, për shqyrtim e miratim në Kuvend, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2025

PËR

**DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 29, DATË 30.03.2023, “PËR TATIMIN MBI TË
ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe nenit 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 29, datë 30.03.2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 8, pas shkronjës d), shtohet shkronja dh), me përmbajtje si më poshtë:

“dh) përjashtimisht nga përcaktimet e shkronjave a), b), c), ç) dhe d) të këtij neni, artistët, të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Shqipërisë, nuk do të konsiderohen rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë për një periudhë prej 24 muajsh.”

Neni 2

Në nenin 11, pas shkronjës f), shtohet shkronja g), me përmbajtje si më poshtë:

“g) të ardhurat nga sponsorizimet, deri në masën sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja p.”

Neni 3

Në nenin 12, në pikën 1, shkronja ç), në fund të pikës “ii”, shtohen paragrafët, me përmbajtje si më poshtë:

“Ky rregull nuk zbatohet nëse individ i vetëpunësuar, pavarësisht të ardhurave të përfituara sipas përcaktimeve të shkronjës ç), pikat “i” dhe “ii”, vetëdeklaron në Deklaratën e Statusit të Vetëpunësuarit, pranë drejtorisë tatimore rajonale ku është i regjistruar, se nuk është në kushtet e të ardhurave nga punësimi. Deklarata e Statusit të Vetëpunësuarit është sipas modelit në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe dorëzohet në të njëjtën periudhë me Deklaratën e të ardhurave personale nga të ardhurat nga biznesi, brenda muajit mars. Kjo Deklaratë shërben si mjet vlerësimi nga administrata tatimore sipas ligjit të procedurave

tatimore, për të përcaktuar nëse individ i vetëpunësuar nuk është në kushtet e shmangies tatimore.”

Neni 4

Në nenin 40, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si më poshtë:

“1/1 Të ardhurat nga sponsorizimet, deri në masën sipas sipas kufizimeve të nenit 50, pika 1, shkronja p, nuk konsiderohet të ardhura të tatueshme të korporatës.”

Neni 5

Në nenin 50, në pikën 1, shkronja p), në nënparagrafin “ii”, pas togfjalëshit “... të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës,...” shtohet togfjalëshi “... për veprimtarinë e federatave sportive, si dhe veprimtarinë e sportistëve të cilët kanë fituar tituj për meritë në sport,...”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI